



Këshillat

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. _____ Prot.,

Maliq, më 23.04.2024

PROJEKT-VENDIM - nr. 10

“Për dhënie ndihme financiare të menjëhershme familjeve në nevojë”

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 29, ligjin nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, neni 30, gërma ‘gj’ dhe neni 41, pika ‘2’, VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore si dhe fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III pika 1- Procedura e vlerësimit të dëmeve germa “a” dhe “ë”, për rastin e rënies së zjarrit në banesën e z. Safet Shimbilko, banues në fshatin Vashtëmi, Njësia Administrative Libonik;

i kërkoj Këshillit të Bashkisë Maliq:

1. Të miratojë një ndihmë financiare prej 271 lekë, për familjen e z. Safet Shimbilko, të cilit i’u dogj banesa më datën 17.04.2024 - ku vlera e plotë e dëmit të shkaktuar në banesë nga ana ndërtimore është 212,071 lekë (vlera prej 50 % është 106,035 lekë). Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake është 165.000 lekë. Vlera totale për t’u dëmshpërblyer është 271,035 lekë.

2. Pagesa do të bëhet nga Programi i Mbrojtjes Civile si më poshtë:

Gr.	Kap.	Kod.Prog.	Llog.Eko.	Vlera (000)
17	01	10910	604	271

3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi mbas miratimit të bazueshmërisë ligjore nga institucioni i Prefektit Korçë.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. ____ Prot.

Maliq, më 23.04.2024

Procesverbal-Konstatimi

I mbajtur në datën 23.04.2024 në banesën e z. Safet Shimbilko, banues në fshatin Vashtëmi, Nj. Administrative Libonik, në zbatim të Urdhërit të Kryetarit nr. 211, datë 22.04.2024, komisioni i konstatimit të gjendjes konstatoi se në banesë pati dëme të konsiderueshme nga ana materiale si dhe në orëndi dhe pajisje elektro-shtëpiake si më poshtë:

a-DËME NGA ANA NDËRTIMORE

- 1- Punime çatie
- 2-Punime suvatimi
- 3- Punime dyer /dritare
- 4.Punime bojatisje
- 5.Punime elektrike

b-DËME NË ORENDI DHE PAJISJE

ELEKTROSHTËPIAKE

- 1-Divane, copë 1
- 2- Komodinë, copë 1
- 3- Krevat dopio (Dhomë Gjumi) + dyshek, cope 1
- 4- Karrige, cope 3
- 5-Dollap rrobash, cope 1
- 6- Televizor, cope 1
- 7- Krevat tek + dyshek, cope 1

Komisioni

1. Stiljan Belishta

2.Burbuqe Beshiri


3.Feridon Doda

KRYETARI BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Maliq, më 23.04.2024

Preventiv

Preventivi i dëmit në orendi dhe pajisje të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e z. Safet Shimbilko, banues në fshatin Vashtëmi, Nj. Administrative Libonik të cilit i'u dogj banesa më datën 17.04.2024

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi/Njësi (lekë)	Shuma
1	Divane	Copë	1	30.000	30.000
2	Komodine	Copë	1	8.000	8.000
3	Krevat dopio (Dhomë Gjumi) + dyshek	Copë	1	35.000	35.000
4	Karrige të zakonshme	Copë	3	4000	12.000
5	Dollap rrobash	Copë	1	35.000	35.000
6	Televizor	Copë	1	20.000	20.000
7	Krevat tek + dyshek	Copë	1	25.000	25.000
Totali					165,000

Çmimet e orendive dhe pajisjeve i janë referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2016.

Komisioni:

1-Ilirjan Islamaj

2-Marjana Zhuli


3-Rodjan Mara

KRYETARI BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026



PREVENTIVI

Objekti: Rikonstruksioni i Shtepisë së Djegur

Pronari: Safet Shimbilko

Vëndndodhja: Fshati Vashtemi Njesia Administrative Libonik

Bashkia Maliq

Nr.	Nr. AN	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSI	SASI	ÇMIMI	VLERA
		VI. PUNIME ÇATIE				
1	2.292	Trare tavani te sharuar	m ²	16	456.26	7,300
2	2.219	Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjegulla marseleze	m ²	20	3826.7	76,534
		PUNIME SUVATIMI				
1	2.295	Tavan rrjete teli + suva	m ²	15	2806.70	42,101
2	2.310	Suva brenda mur tulle h=4m me krah llaç të përzier M 25	m ²	40	1052.85	42,114
		PUNIME DYER DHE DRITARE				
1	3.395	Dritare duralumini plastik	m ²	1.3	11343.48	14,747
2	2.388/1	F/ dyer të brendshme tamburate të rimesuara	m ²	1.8	13985.76	25,174
		PUNIME BOJATISJE				
1	2.399	Sherbetosje me gelqere	m ²	52	48	2,496
		IX. PUNIME ELEKTRIKE				
1	480/2	F.V. Tub PVC fleksibel vetshuares (d 16) dj = 20m/m	ml	10	120	1,200
2	2.461/1	F.V. Percjelles bakri PVC 1.5mm	ml	5	32	160
3	2.461/2	F.V. Percjelles bakri PVC 2.5mm	ml	5	49	245
		SHUMA				212,071
		Vlera e shlyerjes së demit prej 50%				106,035

Preventivi është hartuar mbështetur në Manualet e vitit 2024

Preventivoi: Ing.Marjana ZHULI

KOMISIONI I VLERESIMIT

Ilirjan Islamaj

Marjana Zhuli

Rodjan Mara

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË MALIQ

Gëzim TOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE KRIZAVE

Maliq, më datë 23.04.2024

Relacion




Për përcaktimin e masës së ndihmës financiare të menjëhershme për familjen e z. Safet Shimbilko të cilit i është djegur banesa e tij.

Në datën 17.04.2024, ora 09:05 u dogj banesa e z. Safet Shimbilko, banues në fshatin vashtëmi, Njësia Administrative Libonik dhe si pasojë pati dëme nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Bazuar në VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësitë natyrore ose veprimtaria njerëzore", sipas përcaktimit në Kreun III, pikal, gërma "b" Komisioni i Konstatimit të Gjendjes bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 211, datë 22.04.2024, shkoi në banesë dhe përgatiti procesverbalin e konstatimit të gjendjes. Bazuar në procesverbalin e mbajtur u hartuan edhe preventivat për dëmet e shkaktuara nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Në bazë të preventivave dëmi në anën ndërtimore është në shumën 212,071 lekë (50% e vlerës e barabartë me 106,035 lekë). Vlera e dëmit në orendi elektroshtëpiake është 165.000 lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është 271,035 lekë. Mbështetur në preventivat sa më sipër i propozohet Këshillit të Bashkisë për dhënien e ndihmës financiare si më poshtë:

Ti jepet një ndihmë financiare z. Safet Shimbilko për dëmet nga ana ndërtimore në një shumë prej 106,035 lekë, pajisje dhe orendi elektroshtëpiake në një shumë prej 165.000 lekë. Totali për t'u dëmshpërblyer është 271,035 lekë.

Propozimi i mësipërm është bërë duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 29, ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", neni 30 dhe 41 dhe VKM-në nr.329, datë 16.05.2012;

Vendimit nr. 138, datë 26.12.2023 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2024".

	Emër /Mbiemër	Nënshkrimi	Data
Konceptoi:	R.Mara		23.04.2024
	Ll.Kotmillshi		23.04.2024
Përgjegjës Sektori:	S. Belishta		23.04.2024

KRYETARI I BASHKISE

Gëzim TOPCIU



Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel: 0861 2 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Maliq, më datë 23.04.2024

Relacion

Për përcaktimin e masës së ndihmës financiare të menjëhershme për familjen e z. Safet Shimbilko të cilit i është djegur banesa e tij.

Në datën 17.04.2024, ora 09:05, u dogj banesa e z.Safet Shimbilko, banues në fshatin Vashtëmi, Njësia Administrative Libonik dhe si pasojë pati dëme nga ana ndërtimore, si dhe në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake. Bazuar në VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësitë natyrore ose veprimtaria njerëzore”, sipas përcaktimit në Kreun III, pika 1, gërma “b” Komisioni i Konstatimit të Gjendjes bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 211, datë 22.04.2024 shkoi në banesë dhe përgatiti procesverbalin e konstatimit të gjendjes. Bazuar në procesverbalin e mbajtur u hartuan edhe preventivat për dëmet e shkaktuara nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake. Në bazë të preventivave dëmi në anën ndërtimore është në shumën 212,071 lekë (50% e vlerës e barabartë me 106, 035 lekë). Vlera e dëmit në orendi elektroshtëpiake është 165.000 lekë. Vlera totale për t’u dëmshpërblyer është 271,035 lekë.

Mbështetur në preventivat e mësipërme dhe aftësitë financiare të Autoritetit Vendor i kërkojmë Drejtorisë të Financës dhe Buxhetit të akordojë ndihmën financiare të menjëhershme për familjen e z. Safet Shimbilko të cilit i’u dogj banesa si pasojë e rënies së zjarrit dhe jeton në kushte të vështira ekonomike. Lidhur me situatën, mbulimi i dëmit të shkaktuar për familjen e z.Safet Shimbilko të bëhet nga fondit i Mbrojtjes Civile në Bashki në vlerën 271,035 lekë.

Propozimi i mësipërm është bërë duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 29,ligji 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, neni 30 dhe 41 dhe VKM-në nr.329, datë 16.05.2012:

- Vendimit nr. 138, datë 26.12.2023 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2024”.

	Emër /Mbiemër	Nënshkrimi	Data
Konceptoi :	R.Mara		23.04.2024
Përgjegjës Sektori :	S. Belishta		23.04.2024
Përgjegjës Sektori Juridik	J. Thomo		23.04.2024
Drejtores e Financës dhe Buxhetit :	A. Muka		23.04.2024

KRYETARI I BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

Adresa: Bulevardi “Rinia”, Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

SEKTORI M Z SH-se

Nr. 2187 Prot.

Maliq, më 17/04 2024

VËRTETIM ZJARRI

Vërtetojmë se më datën 17/04/2024 ora 09:05, ne objektin, "Godine banimi ,ka rënë zjarr.

Objekti:Godine banimi.

Me pronar z/znj:Safet Shimbilko

Me adresë: Vashtmi Njësia Administrative Libonik Maliq.

Si pasojë e zjarrit të rënë janë diegur këto materiale si: 1 gargerobë,1 krevat ,1dyshek,1komodinë me pasqyrë,1 krevat fëmijësh,1dritare,1derë, 1 tapet.

Për fikjen e zjarrit ka marrë pjesë personeli i stacionit të MZSH-së Maliq,me komandant shërbimi Kristi Xhafkollari dhe dy automjete zjarrfikese me targë AA 071UO dhe me targë AA762 VU më datën 17.04.2024.Nga ndërhyrja u bë e mundur,evakuimi i njerëzve,si dhe shuarja dhe neutralizimi i zjarrit,deri në fikjen e plotë të tij.

Stacioni i MZSH-së disponon dokumentacionin përkatës që vërteton rënien e ketij zjarri.

Ky vërtetim mbahet në tre kopje dhe lëshohet me kerkesën e të interesuarit .

Komandanti i shërbimit

Zjarrfikës Kristi Xhafkollari

Shefi i Sektorit MZSH-së

Kryeinspektor Zjarrfikës Sadik HALIL





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 2166 Prot

Maliq, më 22.4.2024

URDHËR

Nr. 211, Datë 22.4.2024

PËR

**NGRITJEN E KOMISIONEVE TE KONSTATIMIT TË GJËNDJES DHE VLERËSIMIT
TË DËMEVE NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E Z. SAFET SHIMBILKO, FSHATI
VASHTËMI, NJËSIA ADMINISTRATIVE LIBONIK**

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 64 "Kompetencat e Kryetarit të Bashkisë", gërma "a", Ligjit Nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30, gërma "gj", VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Kreu III, pika 1 "Procedura e vlerësimit të dëmeve" gërma "b", për evidentimin e gjendjes së krijuar nga rënia e zjarrit në datën 17.04.2024, në banesën e Z. Safet Shimbilko, banues në fshatin Vashtëmi, Njësia Administrative Libonik,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit të Konstatimit të Gjëndjes dhe Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve për evidentimin e situatës nga rënia e zjarrit në shtëpinë e Z. Safet Shimbilko, fshati Vashtëmi, Njësia Administrative Libonik, me përbërje si më poshtë:

Komisioni i Konstatimit

- a) Stiljan Belishta
- b) Burbuqe Beshiri
- c) Feridon Doda

Komisioni i Vlerësimit

- a) Ilirjan Islamaj
- b) Marjana Zhuli
- c) Rodjan Mara

2. Komisionet të hartojnë proces-verbalet e konstatimit të dëmeve dhe vlerësimit të dëmeve të shkaktuara, për tja bërë prezent Këshillit të Bashkisë.
3. Të njoftohet Sektori i Mbrojtjes Civile pranë Prefekturës së Qarkut Korçë.
4. Të plotësohet dosja përkatëse me gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ligji duke ndjekur hap pas hapi ecurinë e problemit.
5. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen komisionet e ngritura në pikën 1 të këtij urdhëri.
6. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu



